

DEKLARATA E MINISTRAVE TË GRUPIT TË KONTAKTIT

New York City , 20 shtator 2006

Qyteti i Nju Jorkut – 20 shtator 2006 Ministrat e Grupit të Kontaktit, bashkë me Përfaqësuesin e Lartë të Bashkësisë Evropiane, Kryesinë e Bashkësisë Evropiane, Komisionerin Evropian për Zgjerim, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, zyrtarët e OKB-së duke përfshirë edhe Përfaqësuesin Special të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, dhe Emisarin Special të OKB-së Martti Ahtisaari, u takuan më 20 shtator në Nju Jork për të diskutuar rreth procesit për statusin e ardhshëm të Kosovës.

Meqenëse ky proces po hyn në një fazë vendimtare, Ministrat shpresojnë për një zgjidhje të qëndrueshme të çështjes së fundit të rëndësishme që ndërlidhet me shpërbërjen e Jugosllavisë. Kjo do të shtonte dukshëm stabilitetin në rajon. Ministrat ripohuan përkushtimin e tyre që të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për arritjen e një marrëveshjeje të negociuar gjatë vitit 2006.

Ministrat rikujtojnë që procesi për statusin e Kosovës është i bazuar në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1244 dhe që Këshilli i Sigurimit dhe Grupi i Kontaktit do të vazhdojnë të luajnë rolet kryesore. Ministrat e shprehin vlerësimin e tyre të lartë për Emisarin Special të OKB-së për zhvillimin e negociatave intenzive për tetë muaj. Ata i nxisin palët që ta respektojnë procesin e OKB-së dhe të punojnë në mënyrë konstruktive nën udhëzimin e Emisarit Special për tejkalimin e dallimeve ndërmjet qëndrimeve të palëve. Grupi i Kontaktit do ta monitorojë nga afër nivelin e angazhimit konstruktiv të të dyja palëve dhe do të nxjerrë përfundimet gjegjëse nga kjo.

Sa i përket statusit politik të Kosovës, Ministrat e pranojnë se dallimet mes qëndrimeve të Beogradit dhe Prishtinës mbesin, siç ishte bërë e qartë në takimin e nivelit të lartë në Vjenë me 24 korrik. Ministrat i përkrahin përpjekjet e Emisarit Special për të punuar me palët në bashkëpunim me Grupin e Kontaktit për të arritur deri te një rezultat real që e përmirëson stabilitetin rajonal, që është i pranueshëm për popullin e Kosovës dhe që e ruan karakterin multi-etnik të Kosovës. Përpjekjet për një zgjidhje të negociuar nuk duhet të vënë në dyshim faktin se asnjëra palë nuk mund të bllokojë njëanshëm përparimin e procesit të statusit. Ministrat inkurajuan Emisarin Special për përgatitjen e një propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit dhe në bazë të kësaj ti angazhojë palët për lëvizjen e procesit negociues përpara.

Ministrat i nxisin Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës dhe udhëheqësit e të gjitha komuniteteve të Kosovës që të shpejtojnë përpjekjet për implementimin e Standardeve të miratuara nga OKB-ja, dhe që të promovojnë pajtimin dhe ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve etnike. Implementimi i Standardeve duhet të vazhdojë gjatë procesit të statusit dhe do të jetë një faktor për përcaktimin e progresit. Ata e përsëritën thirrjen e tyre Beogradit për të ndërprerë pengimin e serbëve të Kosovës që të marrin pjesë në institucionet e Kosovës.

Ministrat i mirëpresin përpjekjet e tanishme për t'u përgatitur për implementimin e një marrëveshjeje, duke përfshirë vazhdimin e pranisë ushtarake për të siguruar një ambient të qetë dhe të sigurtë, dhe vazhdimin e një pranie civile ndërkombëtare për të mbikëqyrur implementimin dhe për të siguruar përmbushjen e marrëveshjes.